



REPUBLIKA E SHqipëRISE

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË KAVAJË

KËRKESË

pËR VENDOSJEN E MASËS SË SIGURIMIT PASUROR rË
SEKUESTROS PREVENTIVE MBI PASURITË E
PALUAJTSHME

Drejtuar : Gjykatës së Rrethit Gjyqësor
Kavajë

Kërkues : Prokuroria e pranë Gjykatës së
Shkallës së
Parë Kavajë, përfaqësuar nga pro
Gentian Habazaj
Vendosjen e masës së sigurimit

Objekti : pasuror të
sekuestros preventive

Baza Ligjore : Neni 274 i Kodit të Procedurës Penale

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka regjistruar procedimi penal nr. 189, Viti 2017, për veprat penale të "Falsifikim i dokumentave" dhe "Shpërdorim i detyrës" të parashikuara nga nenet 186 dhe 248 të K.Penal.

Nga veprimet hetimore ka rezultuar dyshimi se disa funksionarë dhe ish funksionarë të ZVRPP Kavajë dhe ish komuna Spille janë të përfshirë në krijimin e praktikave fiktive dhe të regjistrimit në kundërshtim me ligjin të pasurive të mësipërme.

Nga aktet e këtij procedimi rezulton se nga Drejtoria për Hetimin e Krimit . Ekonomik e Financiar në Drejtorinë e Policisë së Shtetit Tiranë janë referuar materialet hetimore të cilat bëjnë fjalë për dyshimin e falsifikimit të dokumentave në kuadër të kalimit tën pronësisë mbi pasurinë nr.35/31 në emër të shtetases Jolanda Tafa, ndodhur në bregdefrl e Spilles në Kavajë. Nga veprimet hetimore ka rezultuar se kjo pasuri në bazë të dokumentacionit në ZVRPP rezultonte

tokë pa frut ndërsa rënë pas është regjistruar në ZVRPP si tokë bujqësore me zërin kadastral "arë" e përfutuar në bazë të një AMTP të vitit 2000. Ka rezultuar, në veprimet para hetimore, se nga Këshilli i Qarkut Tiranë me shkresën nr.608 prot., dt. 10.04.2017 është kthyer përgjigje nga ku rezulton se shkresa me nr.3032/2 prot., dt.28.12.2012, rwa arkivi i Këshillit të Qarkut Tiranë, i përket shtetases Mynyre Dervishi për parcelën me nr.65 me sip.8600 m2 dhe shkresa me nr.174/1 prot., dt.25.02.2015 nuk i përket protokollit të Këshillit të Qarkut Tiranë por me nr.174 prot., dt.16.01.2015 është protokoluuar vendimi i Drejtorisë së Financave të kësaj institucioni. Ky konfirmim është kryer për shkak se shkresa nr.3032/2 prot., dt.28.12.2012 dhe ajo me nr.174/1 prot., dt.25.02.2015 të Këshillit të Qarkut Tiranë janë përdorur në ZVRPP Kavajë për të regjistruar AMTP në emër të shtetases Jolanda Tafa.

Në kuadër të veprimeve hetimore të këtij procedimi penal në ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë, duke qënë se gjatë hetimit kanë rezultuar dyshimet të arsyeshme se e njëjta praktikë e dyshuar e falsifikuar dhe në kundërshtim me ligjin, është përdorur në ZVRPP Kavajë edhe në praktikë të tjera pronësore, janë sekuesfruar dokumentacionit e regjistrimit të të gjitha pasurive të paluajtshme për parcelat me nr.1, 35, 37 dhe 178 të ZK 3501 ndodhur në Spille Kavajë (bregdeti). Nga verifikimit i këtyre praktikave ka rezultuar dyshimi se po e njëjta praktikë konfirmimi të AMTP dhe korespondence me Këshillin e Qarkut Tiranë është aplikuar për të gjitha këto parcela, duke krijuar dyshimin që janë përdorur shkresa me numra protokollit fiktiv të Këshillit të Qarkut Tiranë për pasuri të ndryshme, në emër të personave të ndryshëm, me data të ndryshme dhe për konfirmimin e AMTP të ndryshme. Po ashtu, nga veprimet hetimore në terren ka rezultuar se të gjitha këto pasuri të kthyer dhe regjistruara në emër të ~~personave të ndryshëm~~ me ndërrim të zërit-kadastral Iwa "tokë pa frut" ose pyll" në "tokë bujqësore" dhe në vijim të Ildara me AMTP, në fakt janë ende ranishte në breg të detit' ose pyll. Më pas këto pasuri të regjistruara në emër të shtetasve sipas AMTP janë transaksionuar me anë të kontratave noteriale tek blerës të " dytë Ose të tretë. Për këto arsye ngrihet dyshimi i bazuar se të gjitha praktikat për regjistrimin e pasurive në parcelat nr.1, 35, 37 dhe 178 të ZK 3501 ndodhur në Spille Kavajë (bregdeti) janë bazuar në dokumentacione tërësisht të falsifikuara të tilla si AMTP, shkresat e Këshillit të Qarkut Tiranë. Në ana tjetër ka rezultuar nga të dhënat e para hetimore se personat të cilët kanë përfituar në bazë të këtyre praktikave pasuri të paluajtshme sipas AMTP-ve përkatëse në kushtet kur këta persona kanë qënë trajtuar më parë me tokë bujqësore sipas ligjit nr.501/1991 "Për tokën" pasi kanë qënë pjesë e familjeve bujqësore më datë 01.08.1991 apo edhe raste kur AMTP-të janë gjetur me vula të skanuara, pa nënshkrime, pa numra dhe data etj.

Nga veprimet hetimore ka rezultuar se AMTP-të e përdorura për regjistrimin e pasurive dhe kalimin e pronësisë nga shtet në privat janë të gjitha të pas vitit 2000.

Po ashtu rezulton se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka regjistruar procedimi penal nr.92, viti 2017, për veprën penale të "Shpërdorimit të detvrës" parashikuar nga neni 248 i K.Penal. Ky procedim penal i regjisfruar pas kallëzimit ndaj punonjësve të IKMT Tiranë dhe ka vijuar mbi bazën e dyshimit se funksionarë të Bashkisë Rro qozhinë janë të përfshirë në dhënien me qera të

hapësirave të plazhit publik dhe të stacioneve të plazhit të ndodhur në bregdetin e Spillesë në kundërshtim me kërkesat e ligjit dhe mos ushtrimin e detyrave për kontrollin dhe marrjen e masave ndaj ndërtimeve të kundërligjshme në këtë breçë det. NCEa veprimet hetimore ka rezultuar se në breçë detin e Spillesë janë konstatuar 23 ndërtime objektesh me funksion shërbim plazhi (bar-restorantbeach bar-pishinë). Nga kontrolli i dokumentacionit të këtyre objekteve ka rezultuar se ato janë ndërtuar mbi bazën e një akti shkresor "planvendosje" të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, mungon leja e ndërtimit për të gjitha këto objekte stacion plazhi, ndërtimet janë të karakterit të përhershëm dhe jo të përkohshëm me afat 150 ditor siç e kërkon VKM nr.369/2016 pasi janë përdorur materiale betoni, hekuri etj të paçmontueshme. Ndërkohë që nga ana e autoriteteve të Bashkisë Rrogozhinë rezulton të jetë marrë masë administrative vetëm për një objekt dhe nuk është ndjekur asnjë procedurë evidentimi apo penalizimi për objektet e tjera.

Nga ana tjetër, ka rezultuar se kontratat e qerasë të lidhura mes Bashkisë Rrogozhinë dhe subjekteve të ndryshme janë përpiluar në kundërshtim me ligjin

pasijanë-lidhur kushtet e mungesës së regjistrimit në QKR të disa subjekteve dhe në librin e protokollit të vitit 2016 të Bashkisë Rrogozhinë janë konstatuar numra protokollit të lëna bosh (pa plotësuar), numra protokollit ku shënimet janë bërë me laps dhe që i përkasin pikërisht aplikimeve të subjekteve për lidhjen e kontratave të qerasë në zonën e plazhit.

Nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë është proceduar me bashkimin e procedimit penal nr.189/2017 me procedimin penal nr.92/2017, në një procedim të vetëm, duke qënë se provat e njërit procedim ndikojnë tek procedimi tjetër.

Ndërkohë në lidhje me objektin tjetërsimin në kundërshtim me ligjin të parcelave shtetërore "ranishte dhe pyll" përgjatë bregut të detit në zonën e plazhit të fshatit Spille, ish Komuna Kryevidh, Kavajë, është bërë kallëzim penal dhe nga Kryetari i Këshillit të Qarkut Tiranë. Fakti ka të bëjë me konstatimin e tjetërsimit të parcelave me dokumenta të flasifikuara të Këshillit të Qarkut Tiranë. Mbi këtë

bazë ky institucion ka bërë kallëzim penal në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Kjo e fundit ka regjistruar më datë 22.11.2016 procedimin penal Nr.9190 për veprën penale të "Falsifikimi i dokumenteve" të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal dhe pasi janë kryer veprimet e nevojshme ka vendosur transferimin për kompetencë tokësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë.

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë më datë 28.07.2017 ka regjistruar procedimin penal Nr.311 për veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës" dhe "Falsifikimi i dokumenteve" të parashikuar nga nenet 248 e 186 të Kodit Penal të transferuar nga Prokuroria Tiranë dhe më datë 28.07.2017 është bërë bashkimi i procedimeve në një procedim të vetëm me Nr.92.

Po kështu Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka regjistruar procedimin penal Nr.201 dt.2017 për arsyet e mëposhtme:

Nga ana e Komandës së Forcës Ajrore dhe nga ana e Komisariatit të Policisë Rrogozhinë është bërë kallëzim penal. Në pronën Poligoni i Qitjes Rreth-Greth 1 me numër pasurie 368 është konsatuar prerje pyjesh dhe pastrim i bairhsteve nga një grup punëtorësh. Këta punëtor janë sjellë nga shtetasi Ilir Karkini, i cili ka çertifikatë pronësie për këtë sipërfaqe toke në pyllin dhe rërën buzë detit. Në kallëzim pretendohet se kjo tokë është pronë shtetërore në pronësi të aviacionit shqiptar. Nga Këshilli qarkut Tiranë jemi informuar se shkresa Nr.2147 dt.28.12.2015 e Këshillit të Qarkut Tiranë drejtuar ZVRPP Kavajë, që ka shërbyer për ndryshimin e zërit kadastral nuk është përgatitur nga Institucioni i tyre dhe nuk është dërguar në ZVRPP Kavajë. Ndërsa shkresa NR.5836 dt.18.11.2015 e ZVRPP Kavajë nuk është dërguar fare në Këshillin Qarkut Tiranë as dorazi dhe as me postë. dhe më datë 24.11.2017 është bërë bashkimi i procedimeve në një procedim të vetëm me Nr.92.

Bazuar nga sa rënë sipër si dhe në tërësinë e veprimeve hetimore të

— deritamshtëm vlerësojmë se është e nevojshme vendosja e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive mbi parcelat nr.42 të ZK3175 ndodhur në Rreth-Greth Kavajë dhe pasuritë Nr.97/1 dhe 97/2 të ZK 3501 ndodhur në Spille Kavajë (bregdeti). Vendosja e kësaj mase është e nevojshme pasi lënia e lirë e këtyre pasurive dhe të transaksioneve mbi to krijon mundësinë e tjetërsimit, ndryshimit dhe fshehjes së pronësisë reale cilhe të origjinës së regjistrimit të pasurive dhe të personave të përfshirë në krijimin e praktikave të falsifikuara për përvetësimin e sipërfaqeve të tokës si cilhe krijon mundësinë e kryerjes së zgjatjes dhe rëndimit të pasojave të veprës penale duke sjellë pasojat të rënda materiale interesave të ligjshme të shtetit . si rrjedhojë e humbjes së pronësisë mbi sipërfaqe pylli dhe ranishte apo edhe dëmtim të interesave të ligjshme materiale të personave të tjerë që potencialisht mund të kryejnë blerje në mirëbesim të pasurive të regjistruara dhe që i përkasin këtyre parcelave.

Për këto arsye dhe në bazë të neneve 274 e vijues të K.Pr.Penale,

KËRKOJMË:

1. Vendosjen e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive mbi pasuritë e paluajtshme të ndara sipas ligjit nr. 7501/1991 me anë të AMTP-ve dhe konkretisht si më poshtë .

- Parcela nr.42 kartelën e pasurisë së paolu,a.jtshm.e col.3 fq. 68 m.e sipërfaqe 218000 m.2, ZIC 3175, ndodhur në Rreth Greth Kavajë.
- Pasuria Nr. 97/ 1, ZIC 3501, ndodhur në Spille-Kavajë.
- Parcela nr.97/2 ZIC 3501, ndodhur në Spille-Kavajë.

9 Një kopje e vendimit të gjykatës t'i vihet në dispozicion subjektit që administron objektet e sekuestrimit.

PROKURORI

GENTIAN BAZAJ

Rërkesës i bashkangjitet akte procedurale të fashikullit të procedimit.

REPUBLIKA E SHQIPERISb GJYKATA E RRETHIT GJYQbSOR KAVAJE gr,a002-
00498-12-2017/124 Regi. Them. Vendimi nr. 12-2017-1120/124 Data ardhjes
21.06.2017. Data e Vendimit 27.06.2017

VENDIM "Nü EMIR REPUBLIKÜS"

Gjykata e Rrethit Gjyqösor Kavajë e pörbörö nga:

Durim KADIU — gjyqtar, asistuar nga sekretare
gjyqösore Farije Kaja, sot mö datö 27.06.2017, mori nö shqyrtim ne seancö gjyqösore,
körkesön penale me Nr. 61012-00498-12-2017/124 akti qö i pörket:

KERKUES: Prokuroria pranö Gjykatös së Rrethit Gjyqösor Kavajë, e
pörfaqösuar nga prokurori Kreshnik Ajazi,

OBJEKTI: Vendosja e sekuestros preventive pör pasuritö tö paluajtshme.

Baza Ligjore: Neni 274 i Kodit tö Procedures Penale.

Gjykata pasi shqyrtoi körkesön dhe döjtoi pretendimet pörfundimtare tö Prokurorit Kreshnik Ajazi i cili pörfundimisht körkoi:

Vendosja e sekuestros preventive nö ZVRPP Kavajë nö lidhje mö pasuritö e paluajtshme tö dokumentuara ne procesverbalet e
sekuestrimit tö dokumenteve tö mbajtuara nga oficeri i policisë gjyqösore tö datave 30.05.2017; 01.06.2017; 02.06.2017;
08.06.2017;

06.06.2017; 16.06.2017 dhe 20.06.2017.

VEREN:

Prokuroria e Rrethit Gjyqösor Kavajë ka regjistruar procedimin penal tır. 189, viti 2017, per veprat penale tö "Falsifikim i
dokumentave" dhe "Shpördorim i detyrös" te parashikuara nga nenet 186 dhe 248 tö K.Penal.

Nga veprimet hetimore ka rezultuar dyshimi se disa funksionarö dhe ish funksionarö tö ZVRPP Kavaje dhe ish komuna Spille
janö tö pörfshirö nö krijimin e praktikave fiktive dhe tö regjistrimit ne kundörshtim me ligjin tö pasurive te mösiperme.

Nga aktet e kötij procedimi rezulton se nga Drejtoria pör Hetimin e Krimin Ekonomik e Financiar nö Drejtorine e Policisë së
Shtetit Tiranö janë referuar materialet hetimore tö cilat böjnö fialö pör dyshimin e falsifikimit tö dokumentave nö kuadEr te
kalimit tö Prongsisö mbi pasuring nr.35/3 1 ne emer tö shtetases Jolanda Tafa, ndodhur nö bregdetin e Spilles nö Kavaje. Kjo
pasuri nö bazö tö dokumentacionit nö ZVRPP rezultonte tokö pa frut ndörsa mö pas eshte regjistruar ne ZVRPP si tokö
bujqösore me zerin kadastral "are e pörftuar nö bazö te një ANITP tö vitit 2000. Ka rezultuar gjithashtu, nga veprimet para
hetimnrp Köshilli i Qarkut Tiranö me shkresön nr.608 prot., dt.10.04.2017 öshtë

kthyer nga ku rezulton se shkresa me nr.3032/2 prot., dt.28.12.2012, nga arkivi i Köshillit tö Qarkut Tiranë, i pörket shtetases
Mynyre Dervishi pör parcelën me nr.65 me sip.8600 m2 dhe shkresa me IT. 174/1 prot., dt.25.02.2015 nuk i pörket Protokollit tö
Këshillit tö Qarkut Tiranë por me nr. 174 prot., dt. 16.01.2015 është protokoluuar vendimi i Drejtorisë së Financave tö këtëj
institucioni. Ky konfirmim është kryer pör shkak se shkresa nr.3032/2 prot., dt,28.12.2012 dhe ajo me nr.174/1 prot.,
dt.25.02.2015 tö Köshillit tö Qarkut Tiranë janë pördorur në ZVRPP Kavajë pör tö regjistruar AMTp nëmër tö shtetases
Jolanda Tafa,

Në kuadër të veprimeve hetimore të këtij procedimi penal nga ana e Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Kavajë, duke qënë se gjatë hetimit kanë rezultuar dyshimet arsyeshme se e njëjta praktikë e dyshuar e falsifikuar (Ihe në kundërshtim me ligjin, përdorur në ZVRPP Kavajë edhe në praktika të tjera pronësore, janë SekUestruar dokumentacionet e regjistrimit të të gjitha pasurive të paluajtshme për parcelat me nr.1 35, 37 dhe 178 të ZK 3501 ndodhur në Spille Kavajë (bregdeti), sipas procesverbaleve sekuestrimit të dokumenteve të mbajtura nga oficeri i policisë gjyqësore në ZRPP Kavajë në datat 30.05.2017; 01.06.2017; 02.06.2017; 08.06.2017; 06.06.2017; 16.06.2017

20.06.2017.

Nga verifikimi i këtyre praktikave ka rezultuar dyshimi se po e njëjta praktikë konfirmimi të AMTP dhe korespondence me Këshillin e Qarkut Tiranë është aplikuar për të gjitha këto parcela, duke krijuar dyshimin që janë përdorur shkresa me numra protokollit fiktiv të Këshillit të Qarkut Tiranë për pasuri të ndryshme, në emër të personave të ndryshëm, me data të ndryshme dhe për konfirmimin e AMTP të ndryshme. Po ashtu, nga veprimet hetimore në terren ka rezultuar se të gjitha këto pasuri të dhe regjistruara në emër të personave të ndryshëm me ndërrim të zërit kadastral nga -tokë pa frut" ose "pyll" në 'tokë bujqësore" dhe në vijim të ndara me AMTP, në fakt janë ende ranishte në breg të detit Ose pyll. Më pas këto pasuri të regjistruara në emër të shtetasve sipas AMTP janë transaksionuar me anë të kontratave noteriale tek blerës të dytë ose të tretë. Për këto arsye ngrihet dyshimi i bazuar se të gjitha praktikat për regjistrimin e pasurive në parcelat nr.1, 35, 37 dhe 178 të ZK 3501 ndodhur në Spille Kavajë (bregdeti) janë bazuar në dokumentacione tërësisht të falsifikuara të tilla si AMTP, shkresat e Këshillit të Qarkut Tiranë. Nga ana tjetër ka rezultuar nga të dhënat para hetimore se personat të cilët kanë përfituar në bazë të këtyre praktikave pasuri të paluajtshme sipas AMTP-ve përkatëse në kushtet kur këta persona kanë qënë trajtuar më parë me tokë bujqësore sipas ligjit nr.7501/1991 "Për tokën" pasi kanë qënë pjesë familjeve bujqësore më datë 01.08.1991 apo edhe raste kur AMTP-të janë gjetur me Villa të skanuara, pa nënshkrime, pa numra dhe data etj.

AMTP-të e përdorura për regjistrimin e pasurive dhe kalimin e pronësisë nga shtet privat janë të gjitha të pas vitit 2000.

Po ashtu rezulton se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka regjistruar procedimi penal nr.92, viti 2017, për veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës" parashikuar nga neni 248 i K.Penal. Ky procedim penal i regjistruar pas kallëzimit ndaj punonjësve të IKMT Tiranë dhe ka vijuar mbi bazën e dyshimit se funksionarë të Bashkisë Rrogozhinë janë përfshirë në dhënien me qera të hapësirave të plazhit publik dhe të stacioneve të plazhit ndodhur në bregdetin e Spillesë në kundërshtim me kërkesat e ligjit dhe mos ushtrimin detyrave Nga për kontrollin veprimet hetimore dhe marrjen ka rezultuar e masave se ndaj në bregdetin ndërtimeve e Spillesë të kundërligjshme janë konstatuar në

bregdet.

ndërtime objektesh me funksion shërbim plazhi (bar-restorant-beach bar-pishinë)• kontrolli i dokumentacionit të këtyre objekteve ka rezultuar se ato janë ndëfiuar mbi e një akti shkresor "planvendosje" të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, %gon leja e ndërtimit për të gjitha këto Objekte stacion plazhi, ndërtimet janë të

arakterit të përhershëm dhe jo të përkohshëm me afat 150 ditore siç e kërkon VKM k 369/2016 pasi janë përdorur materiale betoni, hekuri etj të paçmontueshme. Ndërkohë që nga ana e autoriteteve të Bashkisë Rrogozhinë rezulton të jetë marrë masë administrative vetëm për një Objekt dhe nuk është ndjekur asnjë procedurë evidentimi apo penalizimi për objektet e tjera.

ana tjetër, ka rezultuar se kontratat e qerasë të lidhura mes Bashkisë Rrogozhinë dhe subjekteve të ndryshme janë përpiluar në kundërshtim me ligjin pasi janë lidhur kushtet e mungesës së regjistrimit në QKR të disa subjekteve dhe në librin e protokollit të vitit 2016 të Bashkisë Rrogozhinë janë konstatuar numra protokollit të lëna bosh (pa plotësuar), numra protokollit ku shënimet janë bërë me laps dhe që i përkasin pikërisht aplikimeve të subjekteve për lidhjen e kontratave të qerasë në zonën e plazhit,

Nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë është proceduar me bashkimin e procedimit penal nr.189/2017 me procedimin penal nr.92/2017, në një procedim të vetëm, duke qënë se provat e njërit procedim ndikojnë tek procedimi tjetër.

Bazuar nga sa më sipër si dhe _në tërësinë e veprimeve hetimore të deritanishëm prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë i ka kërkuar kësaj gjykate vendosjen e masës së sigurimit pasuror të sekuestrimit preventive mbi parcelat nr.1, 35, 37 dhe 178 të ZK 3501 ndodhur në Spille Kavajë (bregdeti).

Sipas organit të akuzës vendosja e kësaj mase është e nevojshme pasi lënia e lirë e këtyre pasurive dhe të transaksioneve mbi to krijon mundësinë e tjetërsimit, ndryshimit dhe fshehjes së pronësisë reale dhe të origjinës së regjistrimit të pasurive dhe të personave të përfshirë në krijimin e praktikave të falsifikuara për përvetësimin e sipërfaqeve të tokës si dhe krijon mundësinë e kryerjes së zgjatjes dhe rëndimit të pasojave të veprës penale duke sjellë pasojat të rënda materiale interesave të ligjshme të shtetit si rrjedhojë e humbjes së pronësisë mbi sipërfaqe pylli dhe ranishte apo edhe dëmtim të interesave të ligjshme materiale të

personave të tjerë që potencialisht mund të kryejnë blerje në mirëbesim të pasurive të regjistruara dhe që i përkasin këtyre parcelave.

Referuar nenit 274 sipas të cilit kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë Ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron Sekuestrimin me vendim të arsyetuar, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë si gjykatë kompetente për shkak se pronat ndodhen në territorin e saj, në vlerësim të provave të lartpërmendura çmon se duhet vendosur sekuestroja preventive për pasuritë e paluajtshme Parcelat nr.1, 35, 37 dhe 178 të ZK 3501 ndodhur në Spille Kavajë (bregdeti), referuar Pncesverbaleve të sekuestrimit të dokumenteve të mbajtura nga oficeri i policisë gjyqësore të datave 30.05.2017; 01.06.2017; 02.06.2017; 08.06.2017; 06.06.2017;

16.06.2017 dhe 20.06.2017 në ZVRPP Kavajë.

pËR KËTO ARSYE.

Si edhe duke u bazuar në nenin 274 të Kodit të Procedurës Penale, Gjykata

VENDOSI:


Të pranojë kërkesën e organit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Vendosjen e sekuestros preventive për pasuritë e paluajtshme parcelat nr.1, 35, 37 dhe 178 të ZK 3501 ndodhur në Spille Kavajë (bregdeti), sipas procesverbaleve të 30.05 2017; 01.06.2017; 02.06.2017; 08.06.2017; 06.06.2017; 16.06.2017 20.06.2017 në ZVRPP Kavajë, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Ngarkohet prokurori Kreshnik Ajazi për ekzekutimin e këtij vendimi Kundër këtij vendimi lejohet ankimi Gjykatën e Apelit Durres brenda 10 diteve nga dita që i interesuari ka marrë dijeni për sekuestron e vënë, U shpall në Kavajë sot më 27.06.2017

SEKRETARE

GJYQTARJ

Durim KADIU



.1au1

Farije Kaja

nu afu au1 XZ6LLZ90 1 AH NS 3U3S

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
KAVAJË

JU

Nr. 61002-01154-12-2019 (371) Reg,
Datë 07.10.2019

Datë 21.11.2019

VENDIM "NË EMËR Tb REPUBLIKËS"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Ravqjë e përbërë
nga:

GJYQTAR: GENTI DOKOLLARI

Asistuar nga sekretare gjyqësore Arjana Hoxha, sot me datë
21.11.2019, mori në shqyrtim në seancë orqësore me dyer të hapura
kërkesën penale nr. 71004-00440-12-2019 (251) që i përket:

KËRKUES:

Ervis Beu, i biri i Harunit, i dtl. 24.06.1981,
lindur në Bago dhe banues në lagjen nr. 5, Rr,
"Maliq Muço", Durrës, përfaqësuar nga AV. Përparim
Çaça, me deklaram në seancë gjyqësore.

PERSON r
TR.ETË:

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit
Gjyqësor Kavajë, përfaqësuar nga
Prokurori Z. Gezim çopa,

OBJEKTI:

Heqja e sekuestros preventive për pasurinë nr. 35/28, vol. 16, fq. 134, e Ilojit ranishte me sip. 623 m², ndodhur në Spille, Kavajë, e vendosur me Vendimin nr. 12-2017-1120/124, datë 27.06.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

BAZA LIGJORE:

Neni 274/3 i K.Pr.Penale.

Në përfundim të ykimit, Gjykata pasi dëgjoi avokatin e kërkuarit, i cili kërkoi pranimin e kërkesës; Prokurorin, i cili kërkoi pranimin e kërkesës; si dhe shqyrtoi provat e paraqitura,

VËREN:

1. Kërkuari Ervis Beu ka paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë kërkesën me objekt: "Heqja e sekuestros preventive për pasurinë nr. 35/28, vol, 16, fq. 134, e Ilojit ranishte me sip. 623 m², n Kavajë, e vendosur me Vendimin nr. 12-2017-1120/124 datë 27.06.2017 Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë. L'

2. Gjatë gjykimit kërkuari nëpërmjet avokatit r

2.1 Me Vendimin nr, 12-2017-1120/1

Rrethit Gjyqësor Kavajë ka vendosur: "Të pranohet kërkesën e o ga

1

Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Vendosjen e sekuestros preventive për pasuritë e paluajtshme parcelat nr. 1, 35, 37 dhe 178 të 3501, ndodhur në Spille, Kavajë (bregdetit), sipas procesverbaleve të sekuestrimit të dokumentave të mbajtura nga O.P.Gjyqësore të datave 30.05.2017, 01.06.2017, 02.06.2017,

03.06.2017, 06.06.2017, 16.06.2017 dhe 20.06.2017 të ZVRPP Kavajë, pjesë përbërëse e këtij vendimi. Ngarkohet prokurori për zbatimin e këtij vendimi. "

2,2 Në lidhje me kushtet dhe zbatimin e këtij vendimi, i cili është marrë për procedime penale specifike, por edhe po të marrim parasysh momentin aktual të procedimit, jemi brenda kushteve për të kërkuar heqjen e sekuestros si person i interesuar dhe që nuk ka lidhje absolutisht me procedimet penale të sipërcituara dhe që fitimi i pronësisë është bërë sipas akteve të pakundërshtueshme konform ligjit dhe që nuk kanë lidhje me procedimet penale për të cilët gjykata ka vendosur vënien e sekuestros preventive.

2.3 Në këtë kontekst parashtojmë se:

2.3.1 Vendimi është marrë apriori për të parcelat 1, 35, 37 dhe 178 në ZK 3501 në Spille, Kavajë dhe është marrë në mënyrë specifike për nevojat e hetimit në lidhje me AMTP e ndara në kundërshtim me nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën", duke ndryshuar edhe zërin kadastral nga tokë "pa frut", apo "pyll" në tokë bujqësore të Ilojit uarë", si dhe për arsye të procedimit penal nr. 92 të vitit 2017 mbi dhënien me qera të hapsirave të plazhit të Spillesë.

2.3.2 Kërkuari nuk ka lidhje fare me kërkesën, apo hetimin e prokurorisë pasi këtë pasuri prej 536 m² me nr. Pasurie 1/6, ZK 3501, vol. 11, fq. 51, me adresë Spille, pasi buron nga dhurimi prej

babait tim Harun Beu, i cili e ka përfituar nga KKKP dhe më pas me vendim ó'kate të formës së prerë, si trashëgimtar i ish-pronarit Hamide Beu dhe nuk ka lidhje me asnjë AMTP të dhënë referuar ligji "Për tokën".

2.3.3 Kërkuesi ka në pronësi një sipërfaqe toke prej 623 m² me nr. pasurie 35/28, ZK 3501, vol. 16, fq. 134 të Ilojit ranishte, që buron nga një kontratë dhurimi prej babait të tij, i cili e ka përfituar si pasoje e pjesëmit të pasurisë së fituar me vendim ó'kate.

2.3.4 Pra, pasuria nr. 1/6 është përfituar me dhurim dhe është e Ilojit ranishte dhe që origjinën e ka nga një vendim i KKKPronave Kavajë, i konfirmuar me vendim {jykate.

3. Në këtë kontekst, përta më sipër analizuar, shpjeguar dhe faktuar, kërkohmë nga gjykata të heqë sekuestron preventive për pasurinë nr. 35/28, vol. 16, fq. 134, e Ilojit ranishte me sip. 623 m², ndodhur në Spille, Kavajë, e vendosur me Vendimin nr. 12-2017-1120/ 124, datë 27.06.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

4. Nga ana e kërkuesit u paraqitën edhe proxy t përkatëse, të Cilat provonin se pasuria nr. 35/28, ZK 3501, vol. 16, fq. 134 m si 3 m² ranishte nuk buronte nga ndonjë AMTPronësi, po nga VendiDi nr. 17 atë 27.07.2000 i KKKP Kavajë dhe më pas nga Vendi i nr. 1624, datë 2.2 00 i

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

5. Nga ana e prokurorit u rnbajt qendrimi se pasuria nuk ka lidhje me veprat penale për të cilat është inicuar procedimi penal dhe është sekuestruar, prandaj jemi për pranimin e kërkesës.

6. Gjykata vlerëson se dispozita ligjore që gjcn zbatim në rastin konkret është: -Neni 274 i K.Pr.PenaJc, i cili parashikon se: "1. Kur ka rrezik që disponimi i lirisë së një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose t'g zgasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kirkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar. 2. Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo Iloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal. 3. Kur ndryshojnë kushtet e zbatimit, gjykata, me kirkesën e prokurorit ose të interesuarit, e heq sekuestron,"

7. Referuar pretendimeve të kërkuesit, provave të paraqitura dhe dispozitës ligjore, Gjykata çmohet se kërkesa është e bazuar në ligj dhe duhet të pranohet, pasi:

7.1 Pan, me Vendimin nr. 12-2017-1120/124, datë 27.06.2017 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka vendosur: "Të pranohet kërkesën e organit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Vendosjen e seHzeStros preventive për pasuritë e paluajtshme parcelat nr. 1, 35, 37 dhe 178 të ZK 3501, ndodhur në Spille, Kavajë (bregdetit), sipas procesverbaleve të sekuestrimit të dokumentave të mbajtura nga O.P.Gjyqësore të datave 30.052017, 01.062017, 0206.2017, 08.062017, 0606.2017, 16.062017 dhe 20.062017 të ZVRPP Kavajë, pjesë përbërëse e këtij vendimi. Ngarkohet prokurori për zbatimin e këtij vendimi. " Vendimi është marrë në bllok për të parcelat 1, 35, 37 dhe 178 në ZK 3501 në Spille, Kavajë dhe është marrë në mënyrë specifike për nevojat e hetimit në lidhje me AMTP e ndara në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën", duke ndryshuar edhe zërin kadastral nga tokë u pa frut", apo gpyll' në tokë bujqësore të Ilojit garë", në kuader të procedimit penal nr. 89 të vitit 2017 të regjistruar për veprat penale të g Falsifikimit të dokumentave" dhe gShpërdorimit të detyrës", parashikuar nga nenet 186 dhe 248 të K.Penal, si dhe për arsye të procedimit penal nr. 92 të vitit 2017 mbi dhënien me qera të hapsirave të plazhit të Spillesë. Nëpërmjet sekuestron, është Parandaluar mundësia e tjetërsimit, ndryshimit dhe fshehjes së pasurive dhe origjinës së tyre, për të mos sjellë pasoja për shtetin dhe njëkohësisht përfitime për personat nën hetim.

7.2 Sé dyti, ndër pasuritë e sekuestruara është edhe pasuria nr. 35/28, ZK 3501, vol. 16, fq. 134 me sip. 623 m² ranishte, në pronësi të kërkuesit Ervis Beu, e cila është sekuestruar si pjesë e parcelave të pasurisë nr. 35, ZK 3501 të vendimit të mësipërm të gjykatës.

7.3 Së treti, kjo pasuri nuk ka aspak lidhje me procedimet penale nëq. 89 dhe 92 të vitit 2017 të reostruar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë, Pasi kërkuesi nuk ka qënë nën hetim dhe burimi i pasurisë nr. 179, datë 27.07.2000 i KKKP Kavajë dhe më pas endimi kësa datë 28.12.2000 i Gjykatës së ng

Rrethit Gjyqësor Kavajë. D qënë se kjo

është e ligjshme, nuk ka lidhje dhe nuk është produkt i ndonjë VePrimtarie kriminale, sekuestroja e vendosur mbi pasurinë të është e pabazuar në prova dhe nuk duhet të vijojë më.

pËR KËTO ARSYE,

**Gjykata ne mbeshetJe te neneve 274 dhe 379 e vijues të K.Pr.Penaze; V
VENDOS 1:**

1. Pranimin e kërkesës.
2. Heqien e sekuestros preventive për pasurinë nr. 35/28, vol. 16, fq. 134, e llojit ranishte me sip. 623 m², ndodhur në Spille, Kavajë, e vendosur me Vendimin nr. 12-2017-1120/ 124, datë 27.06.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.
3. Urdhërohet Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë për ekzekutimin e këtij vendimi.
4. Shpenzime gjyqësore nuk u evidentuan.
5. Kunder këtij vendimi mund të behet ank-im ne Gjykatën e Apelit Durrës, brenda 10 (dhjetë) ditëve, duke filluar nga e nesermja e shpalljes së vendimit.
6. U shpall në Kavajë, sot me datë 21.11.2019.

SEKRETARE
ARJANA HOXHA

GJYQTAR
GENTI DOKOLLARI

06/12/2019

VHSYI DOK
ENI...

REPUBLIK-A E SHQIPËRISË
GJYFUATA E RRETHIT GJYQËSOR
K A V A J Ë
R E T L L I T

Nr.Regj.Them 61009-01126-12-2017/256
Data e ardhjes 27.12.2017.

Nr.vendimi12-2017-2097/256
Data e Vendimit 29.12.2017

VENDIM
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykala e Rretllit Gjyqësor Kavajë e përbërë nga:

ENTELE SHEDULA- gjyqtare,
asistuar nga sekretare gjyqësore Arjana Hoxha, sot më datë 29.12.2017, mori lië
shqyrtim në seancë gjyqësore.kërkesën penale me Nr. 61009-01126-12-
2017/256 akti që i përket:

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë,
e përfaqësuar liga prokurori Gentian Habazaj.

OBJEKTI: Vendosja e sekuestros preventive për pasuritw të
paluajtshme.

Baza Ligjore:Neni 274 i Rodit të Procedurës Penale.

Gjvkata pasi shqyftoi kërkesën dhe dëgjo pretendimet përfundimtare të Prokurorit Gentian Habazaj i cili përfundimisht kërkoi:Vendosjen e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive mbi pasuritë e paluajtëshme të ndara sipas ligjit Nr. 7501/1991 me anë të AMTP-së dhe konkretisht si më poshtë:
Parcela Nr.42 në kaftelën e pasurisë së paluajtëshme v013,fq 68,me sipërfaqe 2 18.000 m2,zk 3 175,ndodhur në Rreth Greth Kavajë.
Pasuria Nr.97/1 3501 ,ndodhur në Spille -Ravajë,
Pasuria Nr.97/2,zk 3501 ,ndodhur në Spille -Kavaië,
Një kopje e vendimit të gjvkatës ti vihet në dispozicion subjektit që administron objektet e sekuestrimit.;

VËREN SE.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka regjistruar procedimi penal nr.1 89 ,viti 201 7, për veprat penale të "Falsifik'im i dokumentave" dhe "Shpërdorim i detyrës" të parashikuara nën 1 86 dhe 248 të K.Penal.

Nga veprimet hetimore ka rezultuar qyshimi se disa funksionarë dhe ish funksionarë të Z. V.R.P.P Kavajë dhe ish Komuna Spille janë të përfshirë në krijimin e praktikave fiktive dhe të regjistrimit në kundërshtim me ligjin të pasurive të mësipërme.

Nga aktet e këtij procedimi rezulton se nua Drejtoria për Hetimin e Krimit Ekonomik e Financiar në Drejtorinë e Policisë së Shtetit Tiranë janë referuar materialet hetimore të cilat bëjnë fjalë për dyshimin e falsifikimit të dokumentave në kuadër të kalimit të pronësisë mbi pasurinë nr.35/31 në emër të shtetasës Jolanda Tafa,ndodhur në bregdetin e Spilles në Kavajë. Nga veprimet hetimore ka rezultuar se kjo pasuri në bazë të dokumentacionit në Z.V.R.P.P rezultonte tokë pa regjistruar ndërsa më pas është regjistruar në Z.V.R.P.P si tokë bujqësore me zërin kadastral "arë" e përftuar në bazë të një A.M.T.P të vitit 200th Ka rezultuar,- Ilga veprimet e para hetimore, se nga Këshilli i Qarkut Tiranë me shkresën nr.608 prot.,¹ dt. 10.04.2017 është kthyer përgjigje nga ku rezulton se shkresa me nr.3032/2 prot., dt.28.12.0 01⁰, nga arkivi i Këshillit të Qarkut Tiranë, i përket shtetasës Mynyre Dervishi për parcelën me nr.65 Ille sip.8600 m2 dhe- shkresa- me nr.1 74/1 prot., dt,25.02⁰ 015 nuk i përket protokollit të Këshillit të Qarkut Tiranë por me nr.T74 prot., dt. 16.01 2015 është protokolluar vendimi i Drejtorisë së Financave të këtij institucioni. Ky konfirmim është kryer për shkak se shkresa nr.3032/2- prot., dt.28.12⁰ 012- dhe ajo me nr.174/1 prot., dt.25.02.2015 të Këshillit të Qarkut Tiranë janë përdorur në Z.V.R.P.P Kavajë për të regjistruar A.M.T.P në emër të shtetasës Jolanda Tafa.

Në kuadër të veprimeve hetimore të këtij procedimi penal nga ana e Prokurorisë: së- Rrethit Gjyqësor-, Kavajë, duke qënë se gjatë „hetimit kanë rezultuar dyshimet: të arsyeshme se e njëjta praktikë e dyshuar e falsifikuar dhe në kundërshtim me ligjin, është përdorur në Z. V.R.P.P Kavajë edhe në

praktika të tjera pronësore, janë sekuestruar dokumentacionet e regjistrimit të të gjitha pasurive të paluajtshme për parcelat me nr. 1, 35, 37 dhe 178 të

zakonit nr. 7501

e ÁZK 3501 ndodhur në Spille Kavajë (bregdeti). Nga verifikimi i këtyre / praktikave ka rezultuar dyshimi se po e njëjta praktikë konfirmimi të

A.M.T.P dhe korespondencë me këshillin e Qarkut Tiranë është aplikuar për 1 të gjitha këto parcela, duke krijuar dyshimin që janë përdorur shkresa me numra protokollit fiktiv të Këshillit të Qarkut Tiranë për pasuri të ndryshme, 1 në emër të personave të ndryshëm, me data të ndryshme dhe për konfirmimin e A.M.T.P të ndryshme. PC) ashtu, ITa veprimet hetimore në terren ka 1 rezultuar se të gjitha këto pasuri të kthyera dhe regjistruara në emër të personave të ndryshëm me ndërrim të zërit kadastral nga "tokë pa frut" ose "pyll" në "tokë bujqësore" dhe në vijim të lidara me A.M.T.P, në fakt janë

1

ende ranishte në breg të detit ose pvll. Më pas këto pasuri të regjistruara në emër të shtetasve sipas A.M.T.P kanë pësuar transaksione me anë të 1 kontratave noteriale tek blerës të dytë ose të tretë. Për këto arsye ngrihet dyshimi i bazuar se të gjitha praktikat për regjistrimin e pasurive në parcelat nr.1, 35, 37 dhe 178 të ZK 3501 ndodhur në Spille kavajë (bregdeti) janë bazuar në dokumentacione tërësisht të falsifikuara të tilla si AMTP, shkresat 1 e Këshillit të Qarkut Tiranë. Nga ana tjetër ka rezultuar nga të dhënat e para hetimore se personat të cilët kanë përfituar në Iñazë të këtyre praktikave pasuri të paluajtshme sipas AMTP-ve përkatëse në kushtet kur këta persona kanë qënë trajtuar më parë me tokë bujqësore sipas ligjit nr.7501/1991 "Për tokën" pasi kanë qënë pjesë e familjeve bujqësore më datë 01.08.1991 apo edhe raste kur A.M.T.P-të janë gjetur me Villa të skanuara, pa nënshkrime, pa numra dhe data etj.

Nga _____ veprimet hetimore ka rezultuar se A.M.T.P-të e përdorura për regjistrimin e pasurive dhe kalimin e pronësisë nga shtet në privat janë të gjitha të pas vitit 2000.

PQ ashtu rezulton se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka regjistruar procedimin penal nr.92, viti 2017, për veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës" parashikuar nga neni 248 i K.Penal. Ky procedim penal i regjistruar pas kallëzimit ndaj punonjësve të I.K.M.T Tiranë dhe ka vijuar mbi bazën e dyshimit se funksionarë të Bashkisë Rrogozhinë janë të përfshirë në dhënien me qera të hapësirave të plazhit publik dhe të stacioneve të plazhit të ndodhur në bregdetin e Spillesë në kundërshtim me kërkesat e ligjit dhe mos ushtrimin e detyrave për kontrollin dhe marrjen e masave ndaj ndërtimeve të kundërligjshme në këtë bregdet. Nga veprimet hetimore ka rezultuar se në bregdetin e Spillesë janë konstatuar 23 ndërtime objektsh me funksion

shërbim plazhi(bar-restorant-beach bar-pishinë).Nga kontrolli dokumentacionit të këtvre objekteve ka rezultuar se ato janë nclëftuar mbi bazën e një akti shkresor "planvendosje" të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë,mungon Ieja e ndërtimit për të gjitha këto objekte stacion plazhi, nclërtimet janë të karakterit të pël'hershëm dhe jo të përkohshëm me afat 150 ditor siç e kërkon V.K.M nr.369/2016 pasi janë përdorur materiale betoni, hekuri etj të paçmontueshme.Ndërkohë që nga ana e autoriteteve të Bashkisë Rrogozhinë rezulton të jetë marrë masë administrative vetëm për një objekt dhe nuk është ndjekur asnjë procedurë evidentimi apo penalizimi për objektet e tjera.

Nga ana tjetër, ka rezultuar se kontraLat e qerasë të lidhura mes Bashkisë Rrogozhinë dhe subjekteve të nclryshme janë përpiluar në kundërshtim me ligjin pasi janë lidhur kushtet e mungesës së regjistrimit në Q.K.R të disa subjekteve dhe në librin e protokollit të vitit 2016 të Bashkisë Rrogozhinë janë konstatuar numra protokollit të lëna bosh (pa plotësuar),numra protokollit ku shënimet 'jãñë -bërë me laps • dhe që përkasiñ pikërisht aplikimeve të subjekteve për lidhjen e kontratave të qerasë në ' zonën e plazhit.

Nga ana -e Prokurorisë,, së Rrethit 'Gjyqësor- Kavajë 'është proceduar me bashkimin e procedimit penal 'nr.1-89/2017 me procedimiIT penal nr.9212017, në një procedim të vetëm, duke qënë se provat procedim ndikojnë tek procedimi tjetër.'

Ndërkohë- në lidhje me 012jektin! tjetërsimiñ në• kundërshtim• me ligjin të parcelave shtetërore- tranishte cilhec pyll" përgjatë bregut të cletit në zonëm 'e plazhit të fshatit Spille, ish Komuna Kryevidh, Kavajë, është bërë kallëzim penal dhe nga Krvetari i Këshillit të Qarkut Tiranë. Fakti k' a të bëjë me konstatimin e tjetërsimit të parcelave me dokumenta të falsifikuara të këshillit të Qarkut Tiranë. Mbi këtë bazë ky institucioñ ka bërë kallëzim

penal në Prokurorilã Pranë• Gjykatës Šë Sllkallës-së Parë Tiranë.

Kjo' e tundit ka regjistruar më datë 22.1 1.2016 procedimin penal Nr.9190 për veprën penale: të "Falsifikimi: dokumenteve": të parashikuara nga neni 186 i KoditjPena] dhe pasi janë• kuver veprimet nevojshme ka vendosur transferimin për kompetencë tokësore në .Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë më datë 28.07.2017 ka regjistruar prOcediniin penal' Nr131 1 për veprëil peñale të "Shpëidorimit të detyrës"dhe "Falsifikimi i dokumenteve" të parashikuar nga nenei 248 e 186

në procedim.

KAVAJE

nr. 42 të ZK3175 ndodhur në
Rieth-Greth Kavajë dhe pasurisë
Nr.97/1 dhe 97/2 të ZK 3501
ndodhur në Spille Kavajë
(bregdeti). Vendosija e kësaj
mase është e nevojshme pasi
lënia e lirë e këtyre pasurive
dhe të transaksioneve mbi to
krijon mundësinë e tjetërsimit,
ndryshimit dhe fshehjes së
pronësisë reale dhe të origjinës
së regjistrimit të pasurive
dhe të personave të përfshirë
lië krijimin e praktikave të
falsifikuara për përvetësimin e
sipërfaqeve të tokës si dhe
krijon mundësinë e kwerjes së
zgjatjes dhe rëndimit të pasojave
të veprës penale duke sjellë
pasojat të rënda materiale
interesave të ligjshme të shtetit si

të Kodit Penal të transferuar nga Prokuroria Tiranë dhe më datë 28.07.2017 është bërë bashkimi i procedimeve në një procedim të vetëm me Nr.92. Po kështu Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka regjistruar procedimin penal Nr.201/2017 për arsyet e mëposhtme:

Nga ana e Romandës së Forcës Ajrore dhe nga ana e komisariatit të Policisë Rrogozhinë është bërë kallëzim penal. Në pronën Poligoni i Qitjes RrethGreth me numër pasurie 368 është konsatuar prerje pyjesh dhe pastrim i barishteve nga një grup punëtorësh. Këta punëtor janë sjellë nga shtetasi Ilir karkini, i cili ka çertifikatë pronësie për këtë sipërfaqe toke në pyllin dhe rërën buzë detit. Në kallëzim pretendohet se kjo tokë është pronë shtetërore në pronësi të aviacionit shqiptar. Nga Këshilli Qarkut Tiranë jemi informuar se shkresa Nr.2147, dt.28.12.2015 e Këshillit të Qarkut Tiranë drejtuar Z.V.R.P.P Kavajë, që ka shërbyer për ndryshim_in e zërit kadastral nuk është përgatitur nga Institucioni i Lyre dhe nuk është dërguar në Z.V.R.P.P Kavajë. Ndërsa shkresa Nr.5836, dt.18.11.2015 e Z.V.R.P.P Kavajë nuk është dërguar fare në Këshillin Qarkut Tiranë as dorazi dhe as me postë dhe më datë 24.11.2017 është bërë bashkimi i procedimeve në një procedim të vetëm me Nr.92.

Bazuar nga sa më sipër- si dhe në tërësinë e veprimeve hetimore të deritanishëm vlerësojmë se është e nevojshme vendosja e masës së sigurimit

pasuror të sekuestros preventive mbi parcelat nr.42 të ZK3175 ndodhur në Rieth-Greth Kavajë dhe pasurisë Nr.97/1 dhe 97/2 të ZK 3501 ndodhur në Spille Kavajë (bregdeti). Vendosija e kësaj mase është e nevojshme pasi lënia e lirë e këtyre pasurive dhe të transaksioneve mbi to krijon mundësinë e tjetërsimit, ndryshimit dhe fshehjes së pronësisë reale dhe të origjinës së regjistrimit të pasurive dhe të personave të përfshirë lië krijimin e praktikave të falsifikuara për përvetësimin e sipërfaqeve të tokës si dhe krijon mundësinë e kwerjes së zgjatjes dhe rëndimit të pasojave të veprës penale duke sjellë pasojat të rënda materiale interesave të ligjshme të shtetit si

rrjedhojë e humbjes së pronësisë mbi sipërfaqe pylli dhe ranishte apo edhe dëmtim të interesave të ligjshme materiale të personave të tjerë që potencialisht mund të blerje në mirëbesim të pasurive të regjistruara dhe që i përkasin këtyre parcelave.

Referuar nenit 274 sipas të cilit kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kverjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin me vendim të arsyetuar, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë si gjykatë kompetente për shkak se pronat ndodhen në territorin e saj, në vlerësim të provave të lartpërmendura çmon

5

se duhet vendosur sekuestroju preventive për pasuritë e paluajtshme të ndara sipas li 'T' jtit Nr.750 1/1991 me anë të AMTP-së edhe konkretisht si lile poshtë: Parcela Nr.42 në kartelën e pasurisë së paluaitëshme v013,fq 68,me sipërfaqe 2 18.000 m²,zk 3 175,ndodhur në Rrelh Greth Kavajë.

Pasuria Nr.97/1 3501 ,ndodhur në Spille -Kavajë. Pasuria Nr.97/2,zk 3501 ,ndodhur në Spille -kavajë,

PER RËTO ARSYE:

Si edhe duke u bazuar në nenin 274 të Redit të Procedurës Penale,
Gjykata

VENDOSI:

_ Të pranojë kërkesën e organit të Prokurorisë pranë Gjykatës. së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Vendosjen e sekuestros preventive për pasuritë e paluajtshme:

Parcela nr.42, ZR 3 1 75 ndodhur në Rreth Greth Kavajë

Parcela nr.97/1. ZR 3501 ndodhur në Spille Kavajë,

Parcela nr.97/2 ZR 3501 ndodhur në Spille Kavajë,


Ngarkohet Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë për ekzekutimin e këtij vendimi.

kundër këtij vendimi • lejohet allkim në Gjykatën. e Apelit Durrës brenda 10 ditëve , ose 112a dita që i interesuari ka marrë. dijeni për sekuestron e vënë.

- Kavajë me 29. Iⁿ0 17

SEKRETARE

A NA I—IC) XI—IA



GJYOTARE
ENTEËA SHEDULA

